



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Mitrovicës së Jugut
Opština Juzna Mitrovica – Municipality of Mitrovica South



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02-060/01-0038672-1/24 dt. 18.06.2024

Mitrovicë

P R O C E S V E R B A L

Nga mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa

Mbledhja e 30

Koha: 18.06.2024 ora 10:00

Vendi: Salla e Mediave

Të pranishëm: Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Fadil Veseli, Nazmije Sejdiu, Vesel Neziri, Shkurta Shoshollı Musa, Hysen Muzliukaj, Erseka Barani, Muhamet Hoti dhe Xhylljeta Imeri

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza

Drejtori i Drejtoriave

Mungoi:

Mbledhjen e hapi dhe kryesoit Kryesuesja e Kuvendit znj. Vesa Broja e cila theksoi se në zbatim të nenit 52, paragrafi 1, të Ligjit Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale; nenit 11 paragrafët: 1, 2 edhe 5 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 Për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në komunë; nenit 62, të Statutit të Komunës së Mitrovicës; nenit 15, pika 2, të Rregullores Komunale për punën e komiteteve të Kuvendit të Komunës, për sot ka thirrur mbledhjen e tridhjetë të Komitetit për Politikë dhe Financa, me këtë rend dite:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Propozim-vendim për lejim të mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërvshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut
3. Propozim-vendim për miratim të Nismës për Bashkëpunim Ndërkomunal
4. Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027
5. Strategjia për Kulturë 2024-2027

Rendi i ditës u miratua unanimisht.

Pika 1

Procesverbali nga mbledhja e kaluar u miratua unanimisht.

Pika 2

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për lejim të mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërvshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Propozim-vendimin për lejim të mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërvshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut.

Propozim-vendimi për lejim të mjeteve financiare nga subvencionet për familjet e prekura nga vërvshimet dhe shembja e dheut në Komunën e Mitrovicës së Jugut u miratua unanimisht (8-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjtë i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Pika 3

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hap diskutimin lidhur me Propozim-vendimin për miratim të Nismës për Bashkëpunim Ndërkomunal, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtorit të DSHPI-së z. Granit Tmava.

Pas arsyetimit të pikës nga Drejtori i DSHPI z. Granit Tmava, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Sqarim shtesë, unë mendoj që këtë rrugë duhet me e bë niveli qendror, Ministria pasi që janë shumë më shumë komuna dhe është ma lehtë e ekzekutueshme, por tekefundit para publike janë edhe këto të komunave, edhe ato të nivelit qendror, por do të ishte më e zbatueshme edhe më lehtë e menaxhueshme, ne si Komunë e Mitrovicës jemi përfshirë dhe e falënderoj drejtorin që ka sjellë në komitet dhe me e proceduar në Kuvend për shkak se disa komuna tjera veç kanë avancuar në këtë drejtim dhe e kanë aprovuar në asambletë e tyre komunale dhe mos jetë që Komuna e Mitrovicës nuk është pro, këtij projekti. Na jena për me bë këtë projekt. E dimë rëndësinë e projektit, po sidoqoftë mendoj që do të punojmë shumë edhe ngushtë me Ministrinë e linjës që realisht ky projekt të jetë mirë edhe në aspektin teknik, financiar dhe të prokurimit nga niveli qendror. Sidoqoftë, unë ju lus që ta procedojmë tutje, ta aprovojmë, ta bëjmë pjesë të buxhetit për pjesën që neve na takon dhe pastaj me një memorandum tjetër të mirëkuptimit, besoj që specifikohet se kush do t'i udhëheqë procedurat e prokurimit, kush do ta merr mbikëqyrjen, mos del që Komuna e Mitrovicës nuk është pro këtij projekti. Sidoqoftë, unë ju lus që të njëjtin ta përkrahni dhe ta procedojmë tutje për Kuvend dhe të jetë pjesë e tabelave buxhetore dhe buxhetit për financim për periudhën e ardhshme, duke filluar nga viti 2025 e tutje.

Vesel Neziri: Uroj që ky projekt të realizohet, uroj të mos jetë fushatë elektorale. Nuk po flasë për komunën tonë, por të përfshihen të gjithë ato rrugë dhe të lihen për vitin 2025, pra edhe një herë them uroj të realizohet ky projekt dhe mos të jetë fushatë elektorale.

Hysen Muzliukaj: Në bazë të dokumentit që po e shoh, nuk besoj që asnjë prej neve mund të jetë kundër një nisme të tillë. Besoj që dokumenti ka pak mangësi. Do të duhej të na bashkëngjisni edhe miratimin e nismave nga komunat tjera ose një analizë financiare. Unë po e kuptoj që është veç miratimi i nismës por në të njëjtën kohë po dalin fjalët që duhet me shti në projekt-buxhetin tonë, sepse nëse investon ministria, atëherë na nuk kemi nevojë për me shti në projekt buxhetin

tonë. Andaj propozoj që të jetë materiali pak më i më i gjërë për Kuvend dhe le të na bashkëngjiten iniciativat e komunave tjera.

Granit Tmava: Pas këtij veprimi, që do të merret nga të gjitha komunat që të kalohet në Kuvend Komunal, pastaj do të bëhet edhe një marrëveshje bashkëfinancimi, ku do të bëhet komplekt studimi i fizibilitetit të terrenit dhe do të bëhet hartimi i projektit detal teknik, ku kjo nënkuption që pasi që të aprovohet në Kuvend ne mund ta dimë pastaj edhe shumën e projektit, edhe se si do të duket projektit në vijim, pa ndodhur kjo nuk mund të kem diçka konkrete për sa i përket këtyre që sapo i kërkove, ndërsa tek pjesa tjetër, po pse jo, mund t'ua bashkëngjisim edhe më vonë në pjesën që kanë kaluar në Kuvend edhe te komunat tjera.

Kryesuesja Vesa Broja: Atëherë po i bashkëngjisim ato vendime të cilat kanë kaluar në ato komuna.

Xhylljeta Imeri: Unë mendoj që kjo nismë dhe rregullimi i këtyre rrugëve duhet me qenë nga niveli qendror që mos të jenë të ngarkuara nivelet komunale përkundra vështirësive që i kanë, mos të na i lenë barrë, pavarësisht kush do të jetë në pushtet i pëson, përvèç atyre i pësojnë edhe qytetarët me buxhet, pra kisha menduar që me gjetë një ményrë këtu që t'ia dedikojmë atyre dhe t'ua japim si obligim Qeverisë e jo kuvendet komunale.

Kryesuesja Vesa Broja: Atëherë, është e kuptueshme që po bëhet fjalë veç për nismë, për këto çështje tjera, krejt çka vijnë kanë me u detajizuar në memorandumin e bashkëpunimit i cili do të bëhet dhe po besoj që secila komunë ka me pasur pjesën e vet që ka me u nda. Atëherë nëse nuk ka të lajmëruar tjerë për diskutim, e vë në votim Propozim-vendimin për miratim të Nismës për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Propozim-vendimi për miratim të Nismës për Bashkëpunim Ndërkomunal u miratua unanimisht (9-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjtë i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Pika 4

Kryesuesja znj. Vesa Broja para se të hapë diskutimin lidhur me Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027, për ta arsyetuar të njëjtën fjalën ia kaloi Drejtoreshës së DBF-së znj. Igballe Islami.

Pas arsyetimit të pikës nga Drejtoresha e DBF-së znj. Igballe Islami, Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: U theksua që ne veç kemi marrë Qarkoren e parë dhe zakonisht kufijtë e fortë dhe përfundimtar Ministria e Financave i jep me qarkoren e dytë, në qarkoren e parë është shumë shqetësues fakti që, pavarësisht se kemi reflektuar në kornizë, zvogëlimi i numrit te shëndetësia për më shumë se 60 pozita, mendoj që nëasnë formë nuk është e duhura, zvogëlimi i stafit në shëndetësinë primare për Komunën e Mitrovicës, pa hy te komunat tjera sepse nëse marrim numrin e ambulantëve, qendrave të mjekësisë familjare, qendrës kryesore të mjekësisë familjare është vështirë edhe me numrin aktual që me pas mundësi me i ofruar shërbime të nevojshme qytetarëve të Komunës së Mitrovicës. Unë jam në komunikim, drejtoresha është e njoftuar që te shëndetësia kjo mos të reflekton. Dhe një çështje që po e ngriti këtu dhe sigurisht se kjo s'ka me reflektuar për këtë mandat qeverisës, por flasim për Komunën e Mitrovicës, pavarësisht mandatin e ardhshëm kush do ta qeverisë e si do të jetë regjistrimi i popullsisë edhe të dhënat preliminare, nëse niveli qendror nuk reflekton në rishikimin e formulës të granteve, komuna e Mitrovicës do të jetë e dëmtuar me buxhet. Ka nevojë gjithsesi që të reflektohet dhe të ndryshohet formula për financimin e komunave. Ne si komunë do të kemi më pak banorë, sigurisht. Sigurisht

se numri i banorëve do të jetë, po flas me të dhëna preliminare, jo përfundimtare, do të jetë më pak për Mitrovicën për 10.000 banorë dhe kjo do të reflektojë edhe në zvogëlimin e grantit përgjithshëm edhe në zvogëlimin e granteve specifike për arsim dhe shëndetësi, po është shumë e mundshme që, në bazë të numrit të banorëve, pastaj të reflekton edhe te stafi edhe në shëndetësi edhe në arsim. Sigurisht se do të ketë takime, unë inkurajoj zyrtarët e komunës së Mitrovicës, gjitha partitë politike, përfaqësuesit e partive politike por edhe unë si kryetar me bë ndikimin tonë aty ku kemi mundësi që formula e financimit për komunë të pësojë ndryshim. Në të kundërtën pra, po e them te shëndetësia është më se shqetësuese qarkorja e parë buxhetore kur neve na rekomandohet, na kërkohet që të kemi zvogëlim stafit për mbi 60 pozita. Sigurisht se do t'iu drejtoshem edhe me një letër ministrisë që kjo mos me ndodhë, përndryshe jemi në vështirësi se s'mundesh ti me rrit numrin e çerdheve e rritja e çerdheve mos me tu përcjell me rritje të stafit. Tash te arsimi, realisht ne e dimë që disa shkolla e dimë çfarë gjendje janë, numri i nxënësve është zvogëluar. Pra kemi shkuar në kategori, po presim me u reflektua në qarkoren e dytë, qarkorja e dytë do të japë kufij përfundimtar, ku ne do t'i respektojmë, pavarësisht a pajtohem a s'pajtohem, jemi të detyruar t'i respektojmë dhe, do ta zhvillojmë buxhetin në përputhje me orientimet që po jepen në kornizë, por në përputhje edhe me Qarkoren e dytë Buxhetore, çka unë insistoj dhe kërkoj prej të gjitha drejtoreve që vitin e ardhshëm është viti i fundit i këtij mandati, kërkoi shumë realisht që të gjitha projektet ta kanë financimin e plotë, pra mos fillo asnje projekt përvëç projekteve që janë shumëvjeçare, pra edhe një herë po e theksoj mos fillo asnje projekt pa financim të plotë. Për arsy që qeverisjes së ardhshme pa paragjykua se kush do të jetë me i bartë projekte pa financim.

Hysen Muzliukaj: Sa i përket buxhetit a mundeni me na tregu Drejtoreshë apo ju Kryetar se në cilën kategori ka dallim ky buxhet në raport me vitin 2024, ku janë bë rritjet.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: Po rritja ka ardhur te pozicioni i pagave. Edhe arsyja është që do të thotë kemi pasur një rritje të koeficientit të pagave, komuna e Mitrovicës është në mungesë te masa e pagave, aktualisht janë dy arsy: një si rezultat i rritjes së koeficientit pagave dhe e dyta si rezultat i ekzekutimit të vendimeve përmbarimore sidomos për sektorin e arsimit, si informatë shtesë, deri tash të punësuarit në sektorin e arsimit të komunës së Mitrovicës jashtë pagave të rregullta, i kanë realizua diku nën edhe një dy milionë e pesëqind po flasim vetëm për vitin 2024. Dy milionë e pesëqind mijë domethënë është reflektua rritja e buxhetit, z. Muzliukaj te masa e pagave, por një pjesë është reflektuar edhe të mallrat dhe shërbimet. Mendoj që niveli i planifikimit të shpenzimeve kapitale, pasi që është viti i fundit i këtij mandati, duke pasur për bazë që procedurat e prokurimit, e duan kohën e vet dhe kish me qenë më shumë se optimiste me menduar që projektet e reja që do të jenë të përfshira në buxhetin e vitit 2025 kishin mu lidhë kontratat para muajit qershor, atëherë do të thotë realisht duke e pasur për bazë që ne të gjithë e dimë që në vitin e fundit zgjedhor ka edhe fushata, partitë politike garojnë, duke e përfshi edhe partinë e cila është në pushtet në çfarëdo periudhe, prandaj ka shkuar kryesish rritlek tek pagat dhe ka një pjesë tjetër tek mallrat dhe shërbimet pra këtu është reflektuar rritja e buxhetit.

Hysen Muzliukaj: A ka të bëjë mirëfilli i kësaj kur dihet se jeni subjekt i djathtë dhe domethënë zhvillimi edhe investimi në infrastrukturë, mjetet në investime kapitale kthehen në shërbim të qytetarëve, në zhvillim. Edhe tash ky dallimi me mallra dhe shërbime unë e kuptoj këtë çka ju e thatë po por tu ndërlidhë me këtë Kryetar, unë sot kur erdha në mbledhje, është hera dytë brenda javës që është e bllokuar rruga prej udhëkryqit edhe deri te Ura e Gjakut, nuk po ju fajësoj sepse ju nuk shtroni asfalt po ju fajësoj në aspektin rregullativ të asaj që duhet me mirëmbajte, pra është hera e dytë brenda javës që kompania Bageri është duke kryer përmirësimet në rrugë, e besoj një rrugë që është shtruar para vitit të ri, dy ditët ose tri, e të ketë menjëherë përmirësimet do duhej të kishte penallti, do duhej të kishte dënimet për këtë kompani e që të vinin me një raport para

Kuvendit që të dimë edhe ne cilat janë veprimet saktësisht që i keni marrë në raport me këtë kompani, sepse po na shkakton dëm edhe në trafik. Për mua kjo gjë është shqetësuese, pavarësisht se cila parti është në pushtet, kjo nuk është punë politike po është më shumë shqetësuese se një kompani e tillë duhet me pas penallti, kur them penallti duhet me pas dënim, sanksion, pikërisht prej komunës këto sanksione i pres Kryetar, të na i sjellni në Kuvend, ose përmes mjeteve të informimit, me na informuar për qëndrimin që e keni marrë. Pra, këtë e thashë se mandej edhe kjo po ndërlidhet tek mallrat dhe shërbimet.

Kryetari i Komunës z. Bedri Hamza: z. Muzliukaj, faleminderit shumë por te mallrat dhe shërbimet se nuk kthehen taksat veç me investime kapitale, taksat kthehen edhe përmes shërbimeve. Shëndetësia nuk prodhon Investime kapitale po prodhon shërbime dhe ofron shërbime për qytetarë. Për shembull, pajisja e QKMF-së me inventarë, po flas për objekt të ri ajo shkon mallra dhe shërbime. Ndërsa sa i përket projektit të cilit ju e ngritët si shqetësim, kam qenë insistues dhe kam kërkuar që të merren mostrat për projektin që ju po i referoheni rrugës së Shipolit pra janë marrë diku rrith tridhjetë e tetë ose tridhjetë e nëntë mostra edhe janë shkuar në institucionin përkatës. Ata le të dalin me konstatim, a është në rregull, a s'është në rregull. Përtej kësaj aty kontrata ende s'ka përfunduar, punët janë në vazhdim, nuk ka ndodhë pranimi teknik. Jam shumë insistues edhe kërkues, se e kanë detyrë e kanë punë, që mos me e pranuar objektin teknikisht edhe mos me u krye pagesa pa ardhur në gjendjen e duhur që është e pranueshme sipas projektit.

Pasi nuk kishte të lajmëruar tjerë për diskutim Kryesuesja vuri në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2025-2027.

Korniza Afatmesme Buxhetore 2025-2027 u miratua unanimisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe e njëjtë i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Pika 5

Kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin lidhur me Strategjinë për Kulturë 2024-2027.

Pasi nuk kishte të lajmëruar për diskutim Kryesuesja vuri në votim Strategjinë për Kulturë 2024-2027.

Strategjia për Kulturë 2024-2027 u miratua unanimisht (7-për, 0-kundër dhe 0-abstenime) dhe i njëjti i procedohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim.

Mbledhja përfundoi punimet në ora 11:05 min.

Mitrovicë

Procesmbajtës:


Afërdita MAXHUNI

Kryesuesja e Kuvendit


Vesa BROJA

